

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për Planin vendor të veprimit për barazinë gjinore, 2025-2028.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë Z. Besmir Veli.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara te Bashkisë Delvinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me Planin vendor të veprimit për barazinë gjinore, 2025-2028.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në Bashkinë Delvinë, sipas kalendarit më poshtë:

	Data	Ora	Vendi
Delvinë	31.07.2025	11.00	Salla e mbledhjeve të këshillit

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura, në adresat e emaileve: orjetapipiko@bashkiadelvine.gov.al dhe keshillibashkiakdelvine@gmail.com

Linku i dokumentit: <https://www.bashkiadelvine.gov.al/projekt-akte-te-hapura-per-konsultim/>

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, administrata e bashkisë
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Delvinë, organizata joqeveritare dhe shoqëri civile.

Forma e konsultimit: Takim publik.

Qëllimi i këshillimit publik	Diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve sa i takon Planit vendor të veprimit për barazinë gjinore, 2025-2028.
Përshkrimi i çështjes	<p>Fushat kryesore të ndërhyrjes.</p> <p>PVVBGJ 2025 – 2028 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë:</p> <ol style="list-style-type: none">I. Avancimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.II. Zvogëlimi i steroitipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.III. Avancimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm.IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

	<p>Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumentave të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.</p>
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të Koordinatorës së dhunës në familje, të barazisë gjinore dhe specialistes për mbrojtjen e fëmijëve, në bashki: orjetapipiko@bashkiadelvine.gov.al BRENDA DATËS 15.08.2025</p>
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli dhe adiministrata për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë dhe Bashkia Delvinë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit ose personave përgjegjës në bashki të një Përmbledhjeje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhjeje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhjeje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Barazisë Gjinore, të Ekonomisë dhe Financës, ve dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve të cdo rekomandimi dhe opinionit. 4. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit. 5. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar. 6. Monitorimi i zbatimit të tij.
<p>Data e publikimit</p>	<p>28.07.2025</p>